



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

PROCESVERBAL

Mbajtur më 05 dhjetor 2022, në mbledhjen e katërt (4) të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit dhe filloi në orën 10:05

Në mungesë të Kryetarit të Komunës, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nënkryetari i Komunës znj. Marigona Lahu.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z.Nijazi Jashari, Komandant i Stacionit të Policisë; z.Shefki Selmani, përfaqësues i Kishës Protestante-Podujevë; z.Enver Rama, përfaqësues i komunitetit rom; znj.Sevdiye Mustafa, përfaqësuese e komunitetit egjiptian; z.Xhafer Ademi, kryesues i Komitetit për Komunitete dhe përfaqësues i komunitetit rom; znj.Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z.Avni Fetahu, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Nazif Sheqa, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit-Podujevë; dhe z.Edolind Vishaj, përfaqësues i FSK-së; z.Qefser Behrami, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Kërpimëh; z.Nuhi Selimi, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike-Orllan; z.Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z.Bahri Selimi, përfaqësues i Emergjencave Civile-Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe z.Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Ndërsa munguan: z.Mensur Hoti, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islame dhe z.Shemsi Jashari, përfaqësues i OJQ-ve, mediave lokale, komunitetit të biznesit dhe komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: znj. Florentina Osmani, Drejtoreshë e Drejtorisë së Inspeksionit; z. Xhevat Llugaliu-Drejtor i Arsimit; Përfaqësuesit e KFOR-it, z.Xhavit Fejza dhe znj.Arianita Beqa Rraci-UNMIK; OR-5 Ilir Ademi – FSK; Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame, në vend të z. Mensur Hoti.

z. Marigona Lahu, përshëndetje të gjithëve, pasi që Kryetari i Komunës për shkak të angazhimeve nuk mund të marr pjesë, ne do të fillojmë me mbledhjen e KKSB-së. Materialet për mbledhje konsideroj se i keni marrë të gjithë me kohë, a ka ndonjë vërejtje apo plotësim lidhur me rendin e ditës.

Rendi i Ditës

U miratua njëzëri.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 19 tetor 2022

U miratua njëzëri

2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

z. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, fillimisht falën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Nijazi Jashari.

z.Nijazi Jashari, theksoi, nuk do të merrem me statistika sepse jemi në proces të përgatitjes së raportit vjetor të Stacionit policor dhe aty do të përfshihen të gjitha, por natyrisht do të potencojë disa më kryesoret. Në parametrat e sigurisë të cilat cilësohen nga ana e sigurisë, si tensionet politike, religjioze, sociale, krimet e organizuara dhe krimet e rënda etj. dhe duke i marrë parasysh të gjitha këto situata gjendja e sigurisë vlerësohet e qetë, nuk kemi pas tensione nga ato kategori që u përmendën.

Ne kemi marrë disa aktivitete për mbarëvajtjen e rendit dhe qetësisë publike, i referohem periudhës kohore nga mbledhja e kaluar, ku Stacioni policor është përkujdesur për mbarëvajtjen e rendit dhe qetësisë publike, duke përfshirë këtu edhe ruajtjen e sovranitetit të vendit në kuadër të planit operativ ngritja e vigjilencës dhe zbatimi i vendimit të Qeverisë për targat. Gjatë periudhës raportuese janë kontrolluar 7 lokale të ndryshme në qytet me urdhëresë të gjykatës nën dyshimin se në to përdoren substanca narkotike, mbajtje të armëve dhe qëndrim i personave të kërkuar për vepra penale të ndryshme. Janë realizuar një sërë angazhimesh në komunikacion, ku janë hartuar plane konkrete në sigurimin e qarkullimit të sigurt të nxënësve që përdorin transportin publik, janë kontrolluar autobusët, kombibusët, duke mos anashkaluar edhe taksitë ilegale, dhe kjo është bërë në kuadër të sigurisë në komunikacion dhe verifikim të gjendjes faktike, se a janë të licencuar transportuesit. Angazhimet tona policore janë realizuar me inspektorët e komunikacionit. Gjithashtu angazhime janë ndërmarrë edhe në parandalimin e prerjeve dhe vjedhjeve të pyjeve ku bashkërisht me Drejtorinë përkatëse janë sekuestruar sasi e konsiderueshme e masës drusore dhe identifikuar disa recidivist të degradimit të pyjeve për çka edhe është marrë edhe Drejtoria përkatëse në kuadër të kompetencave të tyre ligjore. Janë mbajtur ligjëratat në shkollat të mesme me temën baza ligjore apo përgjegjësia penale që bie mbi moshën e mitur, e që kjo ka ndikuar në psikologjinë e shumë nxënësve që të mendojnë para se të veprojnë apo të inkuadrohen në ndonjë aktivitet kriminal. Janë ndërmarrë edhe një sërë aktiviteteve hetimore në zbulimin e veprave penale, janë kontrolluar shtëpi e prona private ku është arritur që të identifikohen disa kryes të veprave penale të cilat janë argumentuar me dëshmi konkrete dhe paraqitur para organeve të drejtësisë. Janë realizuar urdhëresat të pranuar nga Gjykatat e vendit për kërkim të personave të veprave penale të ndryshme ku angazhimet kryesisht kanë qenë të orientuara tek të dënuarit që kanë mbi dy vepra penale, pa anashkaluar asnjëherë edhe të tjerët, por që shumica nga këta persona në bazë të informatave policore gjenden jashtë shtetit të Kosovës.

Njëra ndër angazhimet ka qenë edhe orari i punës 12 orësh për shkak të rrethanave në Mitrovicën e veriut dhe zbatimit të Vendimit të Qeverisë për targat, ku policia ka luajtur rol të rëndësishëm në ofrimin e sigurisë, ruajtjen e sovranitetit, marrë parasysh vijën kufitare që e kemi me Serbinë. Gjithashtu ju njoftojë se gjatë kontrollit në pikën kufitare në Mërdare, Policia e Kosovës ka hasur në një armë brenda një valixheje në autobus dhe personi është arrestuar në lidhje me rastin, por pas intervistimit është liruar dhe rasti është dërguar në procedurë të rregullt për hetime të mëtejme. Pra personi i dyshuar është arrestuar, intervistuar në stacion policor dhe në bashkëpunim me stacionin policor në

Pejë, është iniciuar rasti si “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Gjatë periudhës raportuese kanë qenë të raportuara dhe trajtuar dy raste të vrasjes, njëra në fshatin Lladoc e tjetra në rrugën “Ali Ajeti”, si dhe ishte një aksident me fatalitet në fshatin Shtedim, ndërsa rast që ka bërë jehonë mediatike dhe shqetësim të komunitetit ishte rasti që ka ndodhur para gjykatës në Podujevë, rast i cili ishte shqetësues edhe për Policinë e Kosovës, por falë reagimit të shpejtë të zyrtarëve policor është arritur që situata të vendoset nën kontroll, të dyshuarit të arrestohen dhe viktimat tjera të parandalohen. Tani jemi në implementim të disa planeve operative që kryesisht kanë për qëllim krijimin e sigurt të qarkullimit në komunikacion, si për lirim të hapësirave publike ashtu edhe për parandalimin e rasteve të aksidenteve në trafik, sezonin dimëror dhe ngritjes së vigjilencës. Kemi zhvilluar fushatën për parandalimin e dhunës në familje, ku nga data 10.12.2022 do të fillohet me ligjërata në tri shkollat e mesme ku do të marrin pjesë policia, QPS, zyra për barazi gjinore. Do të ketë takime në zonën e Orllanit dhe në zonën e Kërpimehut dhe në fund do të mbahet një tryezë e rrumbullakët lidhur me temën, për të diskutuar të arriturat. Gjithashtu kemi asistuar në kërkesë të inspeksionit komunal për rrënimin e objekteve pa leje në fshatin Orllan, ku procesi ka kaluar mirë, pa probleme. Gjithashtu vlen të përmendet edhe një bashkëpunim të mirë që kemi pas me Kishën Protestante Ungjillore, ku si rezultat janë ndihmuar 50 familje me dru për ngrohje për dimër, e në kuadër të kësaj edhe 10 zyrtarëve policorëve u janë shpërndarë nga 5 m² dru përmes sindikatës së Policisë, për çka jemi shumë falënderues.

Do doja të ndalem te kategoria e veprave dhunës në familje, të jap disa statistika. Deri më datë 05.12.2022 në Stacionin Policor në Podujevë janë raportuar 75 raste për dhunë në familje në vitin 2022, 30 prej tyre janë në ndalim të policisë, 22 raste janë me urdhër mbrojtje, dhe 4 raste janë dërguar në strehimore.

Ndërsa sa i përket angazhimit në komunikacion janë shqiptuar 9 mijë e 14 tiketa në trafik, ku rezultojnë të jenë rreth 30% më shumë se vitin e kaluar, dhe janë konfiskuar më shumë se 175 vetura. Kjo ishte sa i përket raportit, ndërsa i falënderojë për bashkëpunimin Komunën, KFOR-in dhe të gjitha organizatat tjera relevante dhe do të vazhdojmë me bashkëpunimin.

z. Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, falënderojmë Komandantin për raportin e paraqitur. Unë e hap debatin lidhur me raportin.

z. Nuhi Selimi, theksoi, dua të ndërlidhem me çështjen e mbylljes së Nënstacionit të Policisë në fshatin Orllan, që është bërë bukur e madhe në atë zonë. Pyetja është se a është diçka serioze mbyllja e Nënstacionit, apo kjo vetëm ka qenë një propagandë e dikujt për qëllime të caktuara, sepse banorët e asaj pjese janë shqetësuar shumë, pasi që është një zonë pak më e ndjeshme. Çështje tjetër është rrënimi i vilave në fshatin Orllan, kjo ka qenë shqetësuese për banorët. Shtrohet pyetja pse është lejuar të ndërtohen pasi që kjo ka qenë e paligjshme. Kjo situatë ka reflektuar edhe në shqetësimin e banorëve të asaj zone, sepse edhe ashtu janë duke u shpërngulur banorët nga ajo pjesë. Kjo që theksova është kërkesë e banorëve e jo e imja personale.

z. Nijazi Jashari, lidhur me rrënimin të objekteve në fshatin Orllan, Policia ka asistuar gjatë procesit të rrënimin duke iu referuar kërkesës nga Drejtoria e Inspeksionit. Ndërsa sa i përket Nënstacionit në fshatin Orllan, aty është bërë një riorganizim i brendshëm i Stacionit në Podujevë, megjithatë këtë nuk e kemi bërë ne, është bërë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale, mirëpo asesi ajo zonë nuk do të mbetet e pa mbuluar në aspektin e sigurisë nga ana e zyrtarëve policor. Nënstacioni policor në Orllan nuk është mbyllur.

z. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, sa i përket çështjes së rrënimit të ndërtimeve pa leje, Komuna ka bërë zbatimin e legjislacionit në fuqi. Këto kanë qenë procedura që nga viti i kaluar dhe palët kanë qenë të njoftuara për pasojat e vendimeve të tyre, kështu që nuk ka pas rrugë tjetër përveç respektimit të rregullativës ligjore. Kam një pyetje për Komandantin e Stacionit Policor, jemi në kuadër të fushatës aktivizmi kundër dhunës në bazë gjinore dhe si statistikë që u përmend nga Komandanti ishin 22 urdhër mbrojtës që janë lëshuar gjatë këtij viti. A ka mundësi të na shpjegoni diçka më gjerësisht rreth urdhrave mbrojtës, si ka bërë monitorimin policia dhe a ka pas ndonjë problem, sepse ky numër më duket mjaft i lartë.

Nijazi Jashari, theksoi, është Njësia e hetimeve në kuadër të Stacionit të Policisë, koordinatori dhe zyrtarët policor të cilët janë të trajnuar për hetimin edhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje. Mund të them se deri tash qëndrojmë më mirë se Stacionet tjera të Policisë. Është bukur vështirë për monitorimin e rasteve, mirëpo deri më tani nuk kemi pas ndonjë telashe, ka pas raste kur janë shkelur urdhrat mbrojtës por nuk kanë qenë raste të rënda. Disa raste i kemi në disa komuna tjera dhe ato duhet të raportohen, i themi se X personin e keni për detyrë ta monitoroni sepse ka urdhër mbrojtës nga gjykata. Procedura e monitorimit është se shkohet kohë pas kohe dhe kanë kontaktet dhe numrat e telefonave, nëse ka ndonjë telashe ajo duhet të lajmërojnë, por gjithashtu i kemi edhe pyetësorët të cilat duhet t'i plotësojnë viktimat, se ka pasur apo jo ndonjë telashe. Në kuadër kësaj fushate referuar dhunës në familje janë kërkuar edhe 6 zyrtar policor për trajnim, në mënyrë që sa më shumë zyrtar policor të jenë të trajnuar në këtë fushë.

z. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, e falënderojmë Komandantin për informatën, shpresoj që rastet e dhunës në familje të zvogëlohen në Komunën tonë dhe në Kosovë në përgjithësi. Kjo ishte rreth raportit të Komandantit të Stacionit policor, ku rezultoi që gjendja e sigurisë në komunën tonë vlerësohet e qetë. Nëse nuk ka dikush diçka tjetër rreth raportit, kalojmë te informata e përfaqësuesit të KFOR-it, e më pas edhe e përfaqësuesit të FSK-së.

Përfaqësuesja e KFOR-it, theksoi se situata e sigurisë në Komunën e Podujevës vlerësohet e qetë, duke ritheksuar gatishmërinë e KFOR-it në ruajtjen dhe sigurinë publike.

z. Edolind Vishaj, theksoi, sa i përket aktiviteteve të FSK-së gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka diçka që vlen të theksohet, sidoqoftë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës gjendja e sigurisë vlerësohet e qetë dhe stabile.

z. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, nëse nuk keni diçka tjetër rreth kësaj pike, kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës.

3. Gjendja nga vërshimet e fundit në territorin e Komunës së Podujevës

z. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, fillimisht fjalën e ka Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit z. Bahri Selimi.

z. Bahri Selimi, theksoi, sikurse jeni në dijeni, nga vërshimet që ndodhën në muajin nëntor 2022, nga vlerësimet e bëra konsiderohen që kanë qenë vërshimet më të mëdha. Niveli i ujit ka qenë më i madhi deri më tash në territorin e Komunës së Podujevës. Më datën 19.11.2022 Drejtoria e Shërbimeve Publike përmes ekipeve mobile ka dalë në terren me qëllim të vlerësimit të gjendjes, duke i'u përgjigjur kërkesave të cilat janë të shumta që kanë arritur nga ana e qytetarëve. Numri i kërkesave ka qenë jashtëzakonisht i madhë edhe pse ishte ditë e diel. Po atë ditë kemi filluar menjëherë me intervenime, kryesisht me debllokimet e lumit Llap dhe lumit të Kaqandollit. Vërshimet kryesisht janë

krijuar nga lumi Llap, duke filluar nga vendet e thella rurale, si Murgull, Tërnavicë etj e deri në fshatin Lupç dhe nga Lumi Kaqandoll duke filluar nga fshatrat Popovë lagja Segaçë e deri në fshatin Lupç. Vlen të ceket se pasoja më e madhe e vërshimeve ka qenë te disa penda të ndërtuara përgjatë lumit, të ndërtuara më parë për nevoja bujqësore, ku është dashur të intervenojmë në disa vende. Ekipet kanë bërë identifikimin e të gjitha kërkesave, në të gjitha lokacionet ku është dashur të intervenohet. Dëmet kanë qenë të theksuara edhe në infrastrukturë, ku në to është filluar me intervenime më datën 20.11.2022 duke vazhduar deri më 24.11.2022, në mënyrë intensive, e që në disa lokacione jemi ende duke vazhduar. Fatmirësisht si Komunë kemi një kod buxhetor të dedikuar për emergjenca, i cili na ka mundësuar të intervenojmë menjëherë ku ka qenë e nevojshme. Si pasojë e reshjeve ka pas edhe bllokim të kanalizimeve, e që në Komunën tonë kemi bukur shumë përzierje të kanalizimeve atmosferike me kanalizimet fekale, e që pasojat reflektojnë edhe në amvisni apo shtëpi. Kemi intervenuar në de bllokim të kanalizimeve dhe atë në 9 vende në bazë të kërkesave, si atmosferike ashtu edhe në ato të ujërave të zeza, ndërsa në infrastrukturën rrugore kemi intervenuar në 16 vende, ku si pasojë e reshjeve ka ardhur deri te dëmtimi i rrugëve. Si pasojë e sheshjeve kemi qenë të detyruar që në dy segmente rrugore vet të bëjmë hapjen e rrugëve (në fshatin Llugë dhe në qytet në rrugën Tetova), pra kemi intervenuar me qëllim që të shpëtojmë shtëpitë nga vërshimet. Në qytet me rënien e nivelit të ujit është intervenuar menjëherë, ndërsa në fshatin Llugë rruga mbetet e mbyllur edhe për një kohë, gjegjësisht kanali mbetet i hapur deri sa të bjerë niveli i ujit. Drejtori në vazhdim theksoi të gjitha lokacionet dhe vendbanimet ku është intervenuar për evitimin e dëmeve nga vërshimet. Ne jemi duke e vëzhguar situatën dhe duke bërë disa intervenime të vogla dhe me përfundim të kësaj si Drejtori jemi duke përgatitur një raport përfundimtar të gjendjes i cili do të na shërbejë për ndarjen e kodeve buxhetore për të intervenuar në këto pjesë, të cilat i kemi identifikuar si pika të zeza. Në këtë situatë fat i mirë ka qenë se për herë të parë në Komunën tonë nuk do të shohim 2 lagjet (Tovërlani dhe e Shalakët) nën vërshim dhe kjo si rezultat i një pune që është bërë vitin e kaluar me vendosjen e kolektorit, sepse sigurisht e dini që ato lagje gjithëherë janë përballur me vërshime.

Kjo ishte një informatë mbi gjendjen edhe pse sikurse e theksova jemi në përgatitje të raportit përfundimtar lidhur me vërshimet e fundit.

z. Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, sa i përket dëmeve të shkaktuara në bujqësi veç është kërkuar raporti i vlerësimit të dëmeve nga Qeveria, dhe vlera është diku mbi një milion euro, kështu që pritet edhe prej Qeverisë për kompensimin e atyre dëmeve. Nëse dikush ka diçka rreth informatës mund ta merrni fjalën.

z. Qefser Behrami, theksoi, po ndërlidhem me informatën e paraqitur nga Drejtori i DSHPMSh, unë si përfaqësues i asaj pjese, menjëherë kam ftuar organet kompetente lidhur me vërshimet dhe ishte kënaqësi që në terren dolën Kryetari i Komunës Policia dhe Drejtori i DSHPMSh. Dëmet nga vërshimet janë të mëdha dhe janë shkaktuar si pasojë e gabimeve të kaluara dhe Komuna duhet të gjejë mënyrën që të sigurojë që ato toka të punohen dhe mos dëmtohen nga vërshimet. Aty është edhe një problem tjetër, fjala është për pendat, e këtë e kam potencuar disa herë. Ato penda nuk janë për vendin ku ne gjendemi, por janë për vendet ku nuk ka mbeturina. Hedhja e mbeturinave bëhet nga persona të pandërgjegjshëm. Nuk e di se a do të ketë mundësi të bëhet një kontroll ndaj kësaj dukurie negative. Është e thjeshtë dhe shumë lehtë të zbulohen personat e tillë të pandërgjegjshëm, sepse po nënkuptohet që këtu kemi të bëjmë vetëm me personat që nuk bëjnë pagesën e shërbimit të kompanisë për marrjen e mbeturinave. Po e ritheksoj se në këto penda duhet intervenuar, duhet bërë një ndryshim, përndryshe çdo herë do të ketë

vërshime të mëdha. Ajo pendë duhet të rregullohet dhe kjo mund të bëhet me pak mjete financiare, në mënyrë që të evitohet si problem. Në emër të banorëve të atij lokaliteti edhe njëherë i falënderojë të gjithë pjesëmarrësit që ishin në terren dhe na ndihmuan në situatën e vërshimeve.

z. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, nëse nuk keni diçka tjetër rreth kësaj pike, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

4. Diskutim rreth përdorimit të mjeteve piroteknike

z. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, fillimisht falën ia kaloj Komandantit të Stacionit të Policisë z. Nijazi Jashari, a kanë ndonjë plan operativ dhe si mendojnë ta kalojnë këtë situatë.

z. Nijazi Jashari, sa i përket mjeteve piroteknike, sigurisht se do të ketë pasi që ato kalojnë nëpër pikat doganore dhe duke qenë të vetëdijshëm se do të ketë furnizime dhe përdorim të mjeteve piroteknike ne do të përgatisim planin operativ, sepse një plan të tillë e kemi pas çdo vit. Pra sigurisht se do të ketë përdorim të mjeteve piroteknike, por do të bëjmë çmos për sa më pak pasoja. Do të angazhohemi maksimalisht dhe me sa më shumë kontrolle. Kjo çështje është diskutuar dhe diskutohet edhe në nivele të larta, si në Drejtorinë e përgjithshme dhe Drejtorinë Rajonale dhe sigurisht kanë planet operative, ndërsa ne inkorporohemi me një plan veprimi në kuadër të planit operativ. Ne do të operojmë në bashkëpunim edhe me inspeksionin, sikurse kemi vepruar edhe më parë.

z. Qefser Behrami, theksoi, pajtoj me atë që theksoi Komandanti se mjetet piroteknike është dashtë të kontrolloheshin që në pikat doganore, por problemi është përdorimi i tyre brenda qytetit. Ka raste kur ato i hedhin para këmbëve dhe si pasojë i shqetësojnë qytetarët, pyetja është se a mund të t'i ndalojmë këto veprime, a mund të ndalojmë që të mos i hedhin në qytet.

z. Nijazi Jashari, theksoi, se ne do të përgatisim një plan të veprimit dhe maksimalisht do të jemi të angazhuar në qytet sa i përket mbajtjes nën kontroll të përdorimit të mjeteve piroteknike. Do të bëjmë përpjekje maksimale që sa më pak të kemi telashe.

znj. Florentina Osmani, Drejtoreshë e Inspeksionit, theksoi, nuk kam diçka konkrete rreth kësaj pike, mirëpo sigurisht edhe ne si Drejtori e Inspeksionit në bashkëpunim me Policinë do të bëjmë maksimumin, në mënyrë që të kemi sa më pak telashe.

z. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, nëse nuk keni diçka tjetër rreth kësaj pike, kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

5. Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Planit të Punës 2023

Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Informatës për punën e KKSB për 2022

z. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, fjalën e ka z. Bahri Selimi Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

z. Bahri Selimi, theksoi, po flas në cilësinë e koordinatorit të KKSB-së. Duhet të ngrisim grupin punues për përgatitjen e planit të punës së KKSB-së për vitin 2023 si dhe informatën për punën e KKSB-së për vitin 2022. Nëse dikush nga përbërja e këshillit ka interesim që të jetë pjesë e grupit le të lajmërohet, nëse nuk ka atëherë propozoj që të mbetet i njëjti grup punues që ka qenë më parë, për faktin se kanë këtë përvojë të punës.

z. Marigona Lahu, Nënkyetare e Komunës, meqë nuk ka propozime të reja, propozoj që Grupi punues për përgatitjen e planit të punës së KKSB për vitin 2023 dhe Informatën për punën e KKSB-së për vitin 2022, të jetë po i njëjti që ishte ngritur gjatë këtij viti.

Nënkryetarja pas procesit të votimit konfirmoi ngritjen e Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së KKSBB-së për vitin 2023 dhe për përgatitjen e Informatës për punën e KKSBB për 2022, në përbërje:

Nijazi Jashari
Mensur Hoti
Shemsi Jashari
Shefki Selmani
Xhafer Ademi
Sevdije Mustafa
Avni Fetahu
Bahri Selimi
Qefser Behrami

Ndërsa në cilësinë e koordinatorit të Grupit punues caktohet z.Shemsi Jashari.

6.Të ndryshme Nuk pat diskutime

Nënkryetarja përfundoi mbledhjen, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut

Mbledhja përfundoi në orën 11:15
Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani



Nr. prot.02-060/04-0099596/22
Podujevë, datë:05.12.2022

Nënkryetarja e Komunës
Marigona Lahu

